



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

Nr. _____ prot

Durrës, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Vaj Lubrifikant per Automjete”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09211100-2;
09211400-5; 09211500-6; 24951000-5

NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS: REF – 64818-10-14-2025

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.560.930 (nje milion e peseqind e gjashtedhjetë mije e neteqind e tridhjetë) lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Shërbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 26, nenit 27, 28, 29, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (b).

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022,2023,2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, nenit 40 pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve.

3. Operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë **të paktën 1(një)** automjet për transportin e mallrave, të cilin duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Për sa me sipër operatori ekonomik ofertues të paraqesë një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Shenim 3.1:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperm prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, te ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të cilat janë të nevojshme për transportin e materialeve të pastrimit në adresat e te gjitha autoriteteve kontraktore . Në zbatim të pikës 1 dhe pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, ku parashikohet: “1.Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, ku përcaktohet “6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”

4. Operatori ekonomik ofertues ne lidhje me artikujt objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 7 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			
Etj.,			

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor për të genë pjesë e planit të zbatimit të kontratës. Rastet e deklaratave te rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ofretues ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

5. Operatori Ekonomik ofretues duhet të paraqesi certifikate të origjinës së mallit objekt prokurimi nepermjet të cilave të vertetojë se malli objekt prokurimi është konform standarteve CE.

6. Operatori Ekonomik Ofretues duhet të paraqesë në SPE Autorizim prodhuesi ose Distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e ofertuara. Në rastet e autorizimit nga distributori, duhet të vertetohet lidhja që distributori ka me prodhuesin. Në autorizim duhet të jete i paraqitur Nr i references së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuësit/Distributirit në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet e nevojshme.

Argumentim: Ky është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kerkohen në këtë procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht me tregues të cilësive të mallrave që kerkohen të blihen dhe që janë prodhuar në standartet apo prodhuar të zyrtarizuar. Ky kriter është jodiskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtperdrejt me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofretues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë shërben për njohjen e mundësisë së Oepër përmbushjen me sukses të kontratës. Në bazë të pikës 1 gërma a dhe c, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

9. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB):

- Kodi: VIII.1.A
- Emertimi përshkrues i veprimtarisë: Tregtim i Vajrave Lubrifikante
-

10. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL):

- Kodi: III.1.A
- Emertimi përshkrues i veprimtarisë: Autorizim mjedisor për magazine vajrash lubrifikante

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”e ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik kryen veprimtarine e tij profesionale ne pershtatshmeri me legjislacionin ne fuqi, licensa profesionale per per prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave objekt prokurimi, te leshuara nga organet kompetente shteterore...

11. Operatori Ekonomik Ofertues duhet te paraqesi Certifikatat ISO Si me poshte:

11.1 Ofertuesit Ekonomik Ofertues duhet te paraqesin Çertifikate Personale ISO 9001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevlefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çerfikata duhet te jete e vlefshme dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.

Ne Çertifikate personale ISO 9001:2015 duhet te jete e perfshire Objekti i prokurimit.

11.2 Operatori Ekonomik Ofertues duhet te paraqesin Çertifikate Personale ISO 14001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te sistemit te mbrojtjes se ambjentit/mjedisit, te cilat do te garantonin mbrojtjen ndaj mjedisit, e perkthyer e noterizuar. Çerfikata duhet te jete e vlefshme dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.

Ne Çertifikate personale ISO 14001:2015 duhet te jete e perfshire Objekti i prokurimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 6, gërma b, pikës 8 dhe 9 të nenit të 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar dhe pikes 1 të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

12. Operatori ekonomik ofertues, ne ditën e hapjes se ofertave (perpara hapjes se tyre), pranë Autoritetit Kontraktor, prane NSHK Durres , duhet të paraqesë të protokolluara nje moster për secilin ze te mallrave objekt prokurimi, sipas listes se kerkuar:

Tabela:

Nr	Emertimi i mallit	Njesia	Sasia
1	Vaj Motorri SAE 10W40	Litra	1
2	Vaj Motorri SAE 15W40	Litra	1
3	Vaj Motorri SAE 20W50	Litra	1
4	Vaj Kamjo SAE 80W90	Litra	1
5	Vaj hidraulik ISO 46	Litra	Min 20
6	Vaj hidraulik ISO 68	Litra	Min 20
7	Antifrizë	Litra	1

8	Alkol frenash	Litra	1
9	Graso	Kg	Min 20
10	AD Blu	Litra	Min 20
11	Vaj Motorri SAE 5w30	Litra	1
12	Vaj Motorri SAE 5w40	Litra	1
13	Vaj kamio ATF	Litra	1

1. Mostrat e dorezuara nga Operatori Ekonomik Ofertues do te dorzohen ne kete forme konfeksioni sipas specifikimeve,ku te lexohet qarte prodhuesi si dhe te shoqerohen me Skeden teknike sipas **Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent**

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, arsyeton: ...”KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoritetikontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa prej produkteve objekt prokurimi...”Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi përparaqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese ne SPE Deklarate ne te cilen te mare persiper permbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar per çdo produkt sipas kerkesave te AK si dhe realizimin e kontrates sipas afatit 10 ditor.

Argumentim: Ne baze te nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar nëse operatori ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas kerkesave dhe specifikimeve.

Afati 10 ditor per levrimin e mallit objekt prokurimi kerkohet sepse te gjithe automjetet e Ndermarjes kane nevojë urgjente per ndrimin periodik te vajit, si edhe shume mjete te Ndermarjes ngaqë jane te amortizuara nga ana motorrike kane nevojë per plotesim vaji te vazhdueshme.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga punonjësit e oficinës së NSHK Durres duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor NSHK Durres në fushën e veprimtarisë së tij.